



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2025/ 1 prot

Datë 30.07.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Nika” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-50075-06-03-2025, me objekt Loti 2 “*Gatim dhe shpërndarje e ushqimit për Njësinë e Sigurisë Publike, Shkodër*”, me fond limit 57,538,125 (pesëdhjetë e shtatë milion e pesëqind e tridhjetë e tetë mijë e njëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH, ose 585,391.44 (pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e një pikë dyzet e katër) euro pa TVSH, zhvilluar me datë 04.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Silver” SHPK me NIPT K88010301S me adresë: Rruga “Bajram Curri”, Nr. Pas 5/247+1N4, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.
- Subjekte të interesuar:** Operatori ekonomik “Nika” SHPK me NIPT J76705047U, me adresë: Bulevardi Skenderbeu, Lagjja “Vasil Shanto”, Godine 8-kateshe, Kati i I-re, Shkodër.

Në datën 28.07.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/5613 dhe me numer 2025/2025 prot, datë 29.07.2025 e operatorit ekonomik “Silver” SHPK për procedurën e “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-50075-06-03-2025, me objekt Loti 2 “*Gatim dhe shpërndarje e ushqimit për Njësinë e Sigurisë Publike, Shkodër*”, me fond limit 57,538,125 (pesëdhjetë e shtatë milion e pesëqind e tridhjetë e tetë mijë e njëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH, ose 585,391.44 (pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e një pikë dyzet e katër) euro pa TVSH, zhvilluar me datë 04.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomikë “Nika” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërmat “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë kriteret për të cilat ankimuesi pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “Nika” SHPK pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Operatori ekonomik “Nika” SHPK nuk plotëson pikën 2.1.1 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”.

2.1.1. Operatorët ekonomikë, duhet të disponojnë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, (katering). Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik (në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

Operatori ekonomik “Nika” SHPK nuk plotëson pikën 2.1.2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”.

2.1.2. Operatorët ekonomikë, duhet të posedojnë të paktën 1 (një) stabiliment të licensuar për prodhimin e ushqimit. Ky stabiliment duhet të jetë brenda bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër. Objekti mund të jetë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Operatori ekonomik “Nika” SHPK nuk plotëson gërmën “dh” dhe “h” të pikës 1 të “Kritereve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit”.

Ofertuesi deklaron se:

dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Gjithashtu operatori ekonomik ankimues “*Silver*” SHPK pretendon se oferta e operatorit ekonomik “*Nika*” SHPK është anomalisht e ulët.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 30.07.2025

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro